



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 612 Prot.

Tiranë, më 23 / 1 . 2019

Nr. Identifikimi 34

Vendimi 02

**REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI :**

Mos paisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi juridik:** “ISFAT-07” sh.p.k.  
**Nr. NIPT-i:** L72016012K  
**Adresa e selisë:** Rruga “Brezare”, banesa nr.5, godinë 3 katëshe pranë shkollës së mesme “Ibrahim Rugova”, Lagjja “Egnatia”, Kamëz, Tiranë  
**Personi përgjegjës:** Fatmir Kurpalaj

Për të zhvilluar projektin “**Objekti i kromit ‘Trull-Surroj’, zona minerare 261**” Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Fshati Trull-Surroj, zona minerare nr. 261, Nr.8247/4 Prot.datë; 23.08.2018, objekti “Trull-Surroj”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës

*(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)*

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", më poshtë po listojmë:

### 1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

*Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:*

- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat.
- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

### 2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

Duke marrë në konsiderat zonën ku do të ushtrohet aktivitetin, gjykojmë se ky projekt shkakton ndikime të rëndësishme negative me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

Gjithashtu informacioni i paraqitur nuk i përmbahet kushteve dhe kriterëve të "Planit të veprimit për veprimtaritë minerare ndërtimore", sipas Urdhërit të përbashkët Nr. 67, datë: 11.03.2018, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**



**MINISTRI  
BLENDI KLOSI**

**1. Anex 1. Harta dhe koordinatat.**

